



Biografi e shkurtër

Znj.Laerta Poda, diplomuar në degën Financë- Kontabilitet në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës, ka përfunduar studimet “Bachelor” në drejtësi në Universitetin “Wisdom” si dhe zotëron titullin MBA në “Delta International University”, New Orleans,USA.

Ka një eksperiencë pune prej 18 vjetësh në sektorin shtetëror, në nivel menaxherial dhe drejtues, kryesisht në institucione pjesë të sistemit të drejtësisë. Ka nisur punë në Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në vitin 2000 si specialiste buxheti, duke kaluar në pozicionin e shefes së sektorit dhe më pas në pozicionin e drejtores së drejtorisë së buxhetit-financës dhe investimeve.

Ka marrë pjesë në proceset e zhvilluara për hartimin e dokumentacionit për financim të gjyqësorit nga projekte të huaja si IPA - Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit si mjeti me të cilin BE-ja mbështet reformat në "vendet e zgjerimit" me ndihmën financiare dhe teknike.

Aktualisht, mban pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.